



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
MINISTRI

DIREKTIVA E MBROJTJES

2012

P E R M B A J T J A

Hyrje	3
RIPUNIMI I DOKUMENTEVE STRATEGJIKË	3
Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes.....	4
Strategjia Ushtarake (SU).....	4
Rishikimi i Tabelave të Organizimit dhe Pajisjeve	5
Paketa e Politikave Drejtuese.....	6
Plani Afatgjatë i Zhvillimit të FASH	6
Paketa e Objektivave të Forcës.....	6
Standardizimi	6
INICIATIVA LIGJORE	7
PERSONELI	7
Barazia gjinore dhe shanset e barabarta	8
ZBULIMI	9
PËRGATITJA PËR MISIONIN KUSHTETUES DHE ZHVILLIMI I KAPACITETEVE OPERACIONALE	9
Koncepti i planëzimit dhe zhvillimit të stërvitjes në FA	9
Prioritetet e stërvitjes gjatë vitit 2012.....	10
MENAXHIMI I MBROJTJES	10
Burimet Njerëzore	10
Burimet Materiale	10
Programimi i burimeve të mbrojtjes	10
Zbatimi i Buxhetit	11
ARSIMIMI USHTARAK DHE STËRVITJA	11
MODERNIZIMI DHE PUNA KËRKIMORE	12
Krijimi i Institutit të Studimeve Strategjike të Sigurisë dhe Mbrojtjes	13
MBËSHTETJA LOGJISTIKE	13
Uniformat e Reja. Implementimi	14
Automatizimi	14
Infrastruktura	14
Transporti.....	14
Mbrojtja e mjedisit.....	15
BASHKËPUNIMI USHTARAK	15
BASHKËPUNIMI ME JASHTË	15
ASGJËSIMI I MUNICIONEVE TE TEPËRTA	16
VITI 2012, VIT I 100 VJETORIT TË PAVARËSISË DHE KRIJIMIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA	17
MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN	18

Hyrje

Reformat intensive të ndërmarra në kuadër të ristrukturimit dhe modernizimit të Forcave tona të Armatosura, politika e jashtme dhe diplomacia aktive dhe mbi të gjitha anëtarësimi i Shqipërisë në NATO e kanë çuar në një stad të ri e cilësisht më të lartë nivelin e sigurisë duke e lidhur në mënyrë të pashmangshme me sigurinë e mbrojtjes kolektive të Aleancës.

Viti 2011 shënoi një numër arritjesh, ndër të cilat spikasin pjesëmarrja në operacionet e NATO-s me një angazhim të lartë në raport me numrin e popullsisë, zhvillimin e stërvitjeve duke përdorur sistemet e NATO-s për vlerësimin e kapaciteteve luftarake, iniciimin e rishikimit të dokumenteve strategjike të mbrojtjes, vazhdimi i procesit të modernizimit, i cili kulmoi me nxjerrjen në det të anijes “ORIKU”, modernizimin e strukturës duke ulur ndjeshëm burokracitë, ndihmën ndaj komunitetit, shkatërrimin e municioneve të tepërta, etj. Të gjitha këto arritje, por jo vetëm, e kanë shndërruar Forcën tonë të Armatosur në një anëtare të denjë të NATO-s.

Direktiva e Mbrojtjes për vitin 2012 mbështetet në synimet dhe kërkesat e dokumenteve themelore të politikës së sigurisë e mbrojtjes së vendit, në përgjegjësitë kushtetuese e ligjore të Ministrit të Mbrojtjes që rrjedhin nga programi i qeverisë për mbrojtjen, si dhe në dokumentet themelore politike e të mbrojtjes të NATO-s dhe BE-së.

Viti 2012 përkon me 100 vjetorin e pavarësisë së Shqipërisë e në këtë kuadër edhe me 100 vjetorin e krijimit të Forcave të Armatosura. Ky përvjetor historik do festohet me madhësi si në tërë vendin tonë edhe në strukturat e Forcave të Armatosura. Organizimi dhe zhvillimi i festimeve të 100 vjetorit të krijimit të FA-se, të jetë në qendër të përpjekjeve e angazhimit të tërë strukturave duke filluar nga Shtabi i Përgjithshëm i FA.

Nisur nga sa me lart, kjo Direktivë të përbëjë bazën, në të cilën të mbështeten planet dhe programet e punës e të veprimtarive të të gjitha strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes e të Forcave të Armatosura në përmbushje të misionit kushtetues si dhe detyrimeve që rrjedhin si vend anëtar i NATO-s.

Ky Dokument është orientues, por zbatimi i tij ngarkon me përgjegjësi Shtabin e Përgjithshëm të FA dhe stafin e Ministrisë së Mbrojtjes të bashkërendojnë përpjekjet dhe veprimtaritë e nevojshme për përmbushjen e saj.

1. RIPUNIMI I DOKUMENTEVE STRATEGJIKË

Dokumentet kryesore strategjike e konceptuale, aktualisht në përdorim të FA, si Strategjia e Sigurisë Kombëtare (2004) dhe Strategjia Ushtarake e Republikës së Shqipërisë (2005) janë përgatitur përpara hyrjes së vendit tonë në NATO. Me gjithë vlerën e meritën e tyre në shërbim të këtij anëtarësimi, por edhe në funksion të zhvillimit të FA në tërësi, tashmë edhe në përgjigje të detyrave të reja që shtron Koncepti i Ri Strategjik i NATO-s, miratuar në Samitin e Lisbonës, shtrohet si domosdoshmëri rishikimi e ripunimi i këtyre dokumenteve në dritën e zhvillimeve të sotme e të perspektivës. Këto dokumente si dhe tërë procesi i planifikimit të mbrojtjes në tërësi duhet të realizohen sipas standardeve të një vendi anëtar të NATO-s. Ky objektivi i rëndësishëm tashmë ka nisur të vihet në jetë me Rishikimin Strategjik të Mbrojtjes.

a. Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes

RSM është një proces i veçantë për nga objektivat por edhe nga shtrirja. Ai përfshin të gjitha institucionet e shtetit që kanë detyrime në fushën e sigurisë. Ai pritet të ketë një rol të veçantë e të japë rekomandime që t'i qëndrojnë kohës në lidhje me krijimin e kapaciteteve operacionale, ndër-ministeriale, për një gamë të gjerë skenarësh që gjykohen si të mundshëm e me ndikim në sigurinë e vendit. Ministria e Mbrojtjes po e udhëheq këtë proces dhe nisur nga nevojat e FA synohet që produkti final, me propozimet për kapacitete operacionale së bashku me vlerësimet e burimeve që do të duhen të vihen në dispozicion, të jenë gati brenda Dhjetorit 2012.

Me qëllim mbështetjen e punës së kryer deri tani, Shtabi i Përgjithshëm i FA të koordinojë punën dhe të aktivizojë kontingjentet më të mira të ekspertëve ushtarakë duke bërë konvertimin e skenarëve në nevoja dhe kapacitete operacionale, jo më vonë se muaji Janar 2012.

Strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe të SHPFA që merren me vlerësimet e kostos, në bashkëpunim me strukturat përkatëse të institucioneve të tjera të angazhuara në proces, të përfundojnë vlerësimin e kostove përkatëse brenda 6-mujorit të parë të vitit 2012. Propozimet e plota të Ministrisë së Mbrojtjes do t'i paraqiten Këshillit të Ministrave, brenda Tetorit 2012.

b. Strategjia Ushtarake (SU) të rishikohet nën dritën e ndryshimeve të ndodhura në mjedisin gjeo-strategjik si dhe t'i referohet Konceptit të Ri Strategjik të NATO-s dhe procesit të Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes. Drafti paraprak i Strategjisë Ushtarake të përfundojë brenda vitit 2012. SU të sigurojë konvertimin e objektivave kombëtare të përcaktuara në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare (*që pritet të finalizohet brenda këtij viti*) në objektiva strategjike ushtarake.

Në SU të bëhet një trajtim më i qartë i strukturës së FA dhe i detyrave që do të kryejë secili prej komponentëve të saj. Dokumenti i ri i SU, të shprehet në mënyrë të qartë e të mos lejojë interpretime të ndryshme për një numër problemesh parimore, si: konceptimin e FA si një Forcë e ndërtuar me bazë “këmbësorinë e lehtë, me lëvizshmëri të lartë, e aftë për kryerjen e misioneve me spektër të gjerë”, ndërtimin e saj në mënyrë “modulare”, konceptin e modernizimit sipas qasjes “smart,” nevojën e përdorimit të burimeve të tjera të vendit në interes të sigurisë e mbrojtjes, etj.

“Smart Defense” është një projekt madhor i Aleancës së Atlantikut të Veriut, i lindur nga nevoja e racionalizimit të përdorimit të burimeve për mbrojtjen dhe sigurinë. Në këtë kuadër si vend anëtar i NATO-s, duhet të mendojmë, konceptojmë e punojmë për ruajtjen e kapaciteteve aktuale, por edhe për ngritjen dhe konsolidimin e kapaciteteve të reja duke mbajtur një nivel ambicieje plotësisht të studiuar e të miratuar nga Aleanca.

Në nivel kombëtar, duhet të thellojmë studimin e kapaciteteve që kemi dhe të atyre që na nevojiten për të ruajtur nivelin e ambicies. Në nivel rajonal, ne duhet të bashkëpunojmë së pari për ngritjen e një mentaliteti të ri bashkëpunimi e mirëbesimi, për zhvillimin e kapaciteteve të përbashkëta në funksion të përbashkët të sfidave të përbashkëta, krizave apo emergjencave civile. Në nivel ndërkombëtar, duhet të zhvillojmë kapacitetet në konsultim me të ngushtë dhe intensiv me aleatët tanë në NATO, me theks te veçantë zhvillimin e kapaciteteve që lidhen me pjesëmarrjen tonë në misionet

dhe operacionet e udhëhequra nga Aleanca, si dhe kapacitetet e zbulimit, vëzhgimit, të policimit ajror, të transportit strategjik, të mbështetjes mjekësore, etj. Ky proces të zhvillohet në bashkëpunim të ngushtë me Komandën e Aleancës për Transformim (ACT) si komanda përgjegjëse për ecurinë e kësaj nisme, e cila duhet të gjejë reflektim në gjithë procesin tonë të planifikimit të mbrojtjes. Po ashtu, procesi tashmë i nisur i rishikimit strategjik të mbrojtjes, i cili ka në fokusin e tij ridezenjimin e strukturës së sigurisë dhe mbrojtjes të bazohet tërësisht në konceptin “smart defense.”

c. Rishikimi i Tabelave të Organizimit dhe Pajisjeve

Miratimi i Konceptit të ri Strategjik të NATO-s dhe nevoja për të zbatuar në praktikë kërkesat e konceptit të “smart defense” kanë startuar procese të rëndësishme të rishikimit të strukturave në shumicën e vendeve anëtare të NATO-s. Në këtë kuadër edhe Forcat e Armatosura të RSH janë përfshirë në një proces të rëndësishëm të Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes, ndër produktet më të rëndësishme të të cilit do të jenë hartimi i dokumenteve kryesorë strategjike dhe doktrinarë ushtarakë, një strukturë e re dhe një tabelë e re e organizimit dhe e pajisjeve të FA.

Si pjesë e këtij procesi, dhe si një parapërgatitje për të, gjatë vitit 2012 FA do të përmbyllin procesin e nisur gjatë vitit 2011, proces i cili synon përmirësimin e strukturës aktuale të FA përmes rishikimit të Tabelave të Organizimit dhe Pajisjeve, me qëllim harmonizimin më të mirë të misioneve me strukturat dhe tabelat e organizimit të njësisve. Përmirësimi strukturor do të prekë struktura të nivelit batalion e poshtë, ose struktura ekuivalente me batalionin për nga klasifikimi organizativ, ndërkohë që përmirësimi i Tabelave të Organizimit dhe Pajisjeve do të prekë gjithë FA.

Përmes këtij procesi duhet të sigurohet:

1. Konkretizimi, si përmes strukturave ashtu dhe përmes procedurave, i ndarjes më të qartë të rolit dhe të përgjegjësisve mes strukturave me mision gjenerimin e forcës dhe atyre me mision përdorimin operacional të forcës.
2. Standardizimi i strukturave të shtabeve të forcave kryesore e atyre mbështetëse dhe, eventualisht, reduktimi i tyre në interes të rritjes së efikasitetit dhe të thjeshtëzimit të procedurave të planëzimit dhe të komandim-kontrollit.
3. Përmirësimi dhe konsolidimi i zinxhirit të komandimit të njësisve operacionale të FT, FD, FA, BMR përmes grupimit të njësisve operacionale në struktura unike, me qëllim që të optimizohet komandimi dhe kontrolli si dhe të reduktohet numri i strukturave planëzuese (shtabet) dhe i strukturave të panevojshme të mbështetjes, duke rritur në të njëjtën kohë nivelin e operacionalitetit të forcave.
4. Konsolidimi i mëtejshëm i institucioneve të arsimimit ushtarak duke synuar përqendrimin e institucioneve arsimore të përgatitjes dhe kualifikimit të oficerëve në një strukturë të vetme. Në përfundim të procesit të konsolidimit të sistemit të arsimimit dhe të stërvitjes individuale në FA do të duhet të konfigurohen qartë tri institucione kryesore përgjegjëse:
 - a. Institucioni i edukimit, arsimimit dhe kualifikimit të oficerëve të FA;
 - b. Institucioni i edukimit, arsimimit dhe kualifikimit të nënoficerëve të FA;
 - c. Institucioni i stërvitjes individuale përgatitjes speciale të ushtarakëve të FA.
5. Përmirësimi i strukturës së gradave ushtarake duke synuar krijimin e një piramide optimale e cila duhet të mbështetet në një bazë më të gjerë gradash të ulëta dhe të mesme dhe në një numër të optimizuar gradash të larta.

6. Shmangia e strukturave të tepërta përmes bashkimit funksional të strukturave me ngjashmëri misioni dhe eliminimit të dublikimeve të konstatuara sidomos në strukturat e mbështetjes logjistike dhe atyre të mbështetjes me shërbime.

I gjithë procesi aktual i rishikimit duhet të shërbejë edhe si një periudhë parapërgatitore, e cila do t'i shërbejë implementimit më të mirë e më të thellë të rekomandimeve që do të rezultojnë nga procesi i Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes.

d. Paketa e Politikave Drejtuese të veprimtarisë së FA, të përfshijë krijimin e kapaciteteve operacionale, personelin, arsimimin-stërvitjen, planifikimin e mbrojtjes, mbështetjen e FA me shërbime etj.

Tematika e tyre të paraqitet për miratim tek Ministri menjëherë pas përfundimit të Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes së bashku me draftet paraprake për secilën prej tyre. Synimi të jete përfundimi i hartimit, diskutimit dhe finalizimin e tyre brenda vitit 2012. Ato duhet të japin një paraqitje të përmbledhur të mendimit në nivelin më të lartë politiko-ushtarak, duke kombinuar parimet bazë dhe udhëzimet e lidhura me to, të formuluar për të drejtuar me sukses reformën e mbrojtjes, në terma afatmesëm.

e. Plani Afatgjatë i Zhvillimit të FASH është një dokument që i jep reformës së mbrojtjes vizionin e duhur afatgjatë. Në mënyrë që të përmirësohet e të ruajë aktualitetin dhe të ndihmojë në vendosjen e objektivave të reformës, ai ka nevojë të ripunohet. Në ripunimin e tij të mbahen parasysh mësimet e nxjerra, kryesisht në operacione, detyrat që burojnë nga "Paketa e Kapaciteteve të Lisbonës", por edhe një vlerësim më realist të tendencave në kushtet e kufizimeve financiare të rajonit e më gjerë.

Procesi i përgatitjes së tij të udhëhiqet nga niveli më i lartë i Shtabit të Përgjithshëm. Dokumenti të përgatitet brenda vitit 2012 dhe ketë një shtrirje kohore deri në vitin 2020. Në planin e ri të sigurohet një lidhje e qartë e objektivave të Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes dhe të Strategjisë Ushtarake me burimet në dispozicion. Plani të parashikojë edhe detyra për përgatitjen me faza, edhe afate për një numër planesh të tjerë mbështetës. Plani i ri i Zhvillimit të FA të konceptohet dhe të shërbejë, si referencë detyruese për aktivitetet e mëtejshme të FA në fushën e Programimit e Buxhetimit të Mbrojtjes.

f. Paketa e Objektivave të Forcës të konceptohet si pjesë integrale e Planit të ri Afatgjatë të Zhvillimit të FA, si dhe e planeve të tjerë mbështetës. SHPFA të zbërthejë secilin nga objektivat e forcës, në dokumente programorë me masa të detajuara që duhen ndërmarrë për realizimin e tyre së bashku me koston dhe afatet përkatëse.

Rishikimi i kësaj pakete të kryhet brenda 4-mujorit të dytë të vitit 2012. Procesi të mbështetet edhe me planet në nivel force e deri në njësi taktike, me qëllim që të garantohet kuptimi e realizimi i tyre në çdo nivel. Brenda muajit Shkurt 2012 të ngrihen grupet e ekspertëve dhe të merren gjithë masat e nevojshme teknike me qëllim ndjekjen e veprimtarive të NATO-s për gjithë vitin 2012, prej të cilave do të dalin detyrime për objektiva të reja force për të gjithë vendet anëtare.

g. Standardizimi: Anëtarësimi i Shqipërisë në NATO, ndër të tjera, i hapi rrugën edhe përfshirjes së FA në procesin e standardizimit të Aleancës. Me krijimin e bazës së nevojshme ligjore, 2011 ishte viti i konsolidimit dhe i zgjerimit të dukshëm të procesit të standardizimit, duke bërë të mundur ratifikimin e 54 STANAG-e. Përvoja e

deritanishme në këtë proces evidenton nevojën për një zgjerim të mëtejshëm të procesit përmes përfshirjes të të gjithë kapaciteteve të FA. Përfshirja e drejtuesve është thelbësore për ecurinë e procesit. FA duhet jo vetëm të përfitojnë prej procesit të standardizimit, por edhe të kontribuojnë si aktorë dhe autorë aktivë, përmes përfshirjes në konceptimin dhe hartimin e STANAG-ëve të rinj, apo përmes përmirësimit të atyre ekzistues. Për sa më sipër, prioritet për vitin 2012, do të jetë:

- Zgjerimi i hartës së ratifikimit dhe përdorimit të standardeve të Aleancës, si dhe rritja e numrit të përdoruesve të tyre në FA.
- Përzgjedhja e STANAG/AP-ve mbështetur në misionin, prioritetet, paketën e OF dhe planin e modernizimit të FA.
- Trajnimi, i strukturave të FA për nivelin e zbatimit në praktikë të kërkesave të STANAG-ve, si dhe monitorimi i njohjes dhe aplikimit të tyre.
- Përfshirja e strukturave të programimit dhe të buxhetimit në kostimin e saktë të efekteve financiare të STANAG-ëve të ratifikuar.
- Përfshirja e strukturave të modernizimit në procesin e planifikimit të masave modernizuese në mbështetje të procesit të standardizimit.
- Përfshirja e strukturave të prokurimit dhe të projektimit në procesin e standardizimit, me qëllim që STANAG-et të shërbejnë si referenca kryesore në hartimin e dokumentacionit të fushave përkatëse.

2. INICIATIVA LIGJORE

Hapat e deritanishëm të reformës në FA, struktura e re që po implementohet, si dhe nevoja për përafrimin e legjislacionit ushtarak me atë të NATO-s dhe BE, kërkojnë rregullimet e nevojshme ligjore. Për këtë, brenda vitit 2012 të rishikohet paketa ligjore e cila normon gjithë veprimtarinë e FA. Objekti i kësaj pune të jetë përfshirja në një ligj të vetëm, “Për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i dispozitave të përmirësuara të ligjeve kryesore të FA, si: “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të FA”, “Për statusin e ushtarakut të FA”, “Për gradat dhe karrierën ushtarake në FA”, “Për disiplinën ushtarake në FA”, “Për medaljet për personelin në FA”. Po ashtu, në kuadër të përfarimit të legjislacionit tonë me atë të NATO-s, brenda vitit 2012 të përfundojë procesi i hartimit dhe miratimit të ligjit “Për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes”.

3. PERSONELI

Gjatë vitit 2012 të përmirësohen e plotësohen politikat, procedurat, planet dhe programet përkatëse për menaxhimin e integruar të përbërësve të ciklit jetësor të personelit, sipas kërkesave dhe afateve të përcaktuara në Strategjinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore 2011-2015.

Sistemi arsimor ushtarak të zhvillohet mbi bazën e koncepteve e programeve të integruara dhe gjithëpërfshirëse për kandidatët për oficerë, si dhe të gjithë personelin ushtarak. Të vijojë hartimi i procedurave, planeve dhe programeve për të mundësuar zbatimin e modelit të ri në ciklin rekrutim-arsimim-kualifikim-trajnim të oficerëve të rinj.

Të rriten standardet për rekrutimin e oficerëve dhe ushtarëve të rinj, duke rritur cilësinë e individëve që hyjnë në Forcat e Armatosura, duke thjeshtuar ndërkohë

procedurat dhe praktikat e procesit të pranimit. Përparësi tu jepet individëve me arsim më të lartë dhe me aftësi e cilësi unike për specialitete të veçanta.

Të përmirësohen procedurat që lidhen me emërimin, vlerësimin dhe ecurinë në gradë e karrierë, përmes aplikimit të praktikave moderne të menaxhimit dhe planifikimit të karrierës, me qëllim rritjen e transparencës dhe barazisë duke synuar normalizimin e piramidës së gradave për të gjitha kategoritë e personelit ushtarak.

Gjatë vitit 2012 të arrihet automatizimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore, së pari të personelit aktiv e atij në rezervë.

Angazhimi ynë për të marrë pjesë me trupa edhe në operacione luftimi krahas operacioneve të tjera paqeruajtëse, të mbështetet me programe për përgatitjen, dhe mbështetjen e personelit që dërgohet në këto misione. Gjatë vitit 2012 të implementohet programi për mbështetjen dhe rehabilitimin psikologjik për ushtarakët pjesëmarrës në misione, si dhe për mbështetjen psiko-sociale të diferencuar për familjet e tyre.

Në bazë të kërkesave dhe afateve të përcaktuara në Strategjinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore 2011-2015, të zhvillohen procedurat, planet dhe programet për përmirësimin e përkujdesjes dhe mirëqenies dhe motivimit së pari për personelin ushtarak aktiv e familjet e tyre, për personelin civil, për trajnimin dhe integrimin në jetën civile të ushtarakëve në rezervë, si dhe për rritjen dhe zgjerimin e motivimit në punë të ushtarakëve.

Në fund të gjashtëmuajorit të parë të vitit 2012 të përfundojnë procedurat e llogaritjes së pensioneve për të gjithë ushtarakët në rezervë e pension si dhe të gjithë ushtarakët aktivë e në rezervë të pajisen me kartë identiteti ushtaraku.

a. Barazia gjinore dhe shanset e barabarta

Politikat gjinore janë tashmë prioritet konstant jo vetëm për Aleancën, por edhe për qeverinë shqiptare. Në këtë kuadër për herë të parë direktiva përmban edhe zhvillimin e politikave të perspektivës gjinore dhe shanset e barabarta. Shtabi i Përgjithshëm i FA si dhe drejtoritë e menaxhimit të personelit në FA të angazhohen aktivisht në implementimin e objektivave për rekrutimin e femrave në Forcat e Armatosura në masën deri 15%, si dhe përzgjedhjen mbi bazën e kriterëve konkurruese me vendet e tjera anëtare të NATO-s.

Të hiqet dorë nga vendosja e femrave ushtarake vetëm në role tradicionale si sekretari, mirëmbajtje etj. dhe të përfshihen ato në çdo funksion, në përputhje me specialitetin, arsimimin dhe gradën. Barazia të jetë parim funksional për arsimimin e femrave duke synuar shpërndarje të drejtë të kurseve.

Përfshirja e femrave në stërvitje të përbashkëta brenda e jashtë vendit, në operacionet e paqes, në misionet tona jashtë vendit dhe sektorët e tjerë të sigurisë të kenë në thelb e ti referohen zbatimit të Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për politikat gjinore.

Ecuria në gradë dhe promovimi në karrierë gjithashtu duhet të synojë shpërndarje më të barabartë të gradave mes meshkujve dhe femrave në FA, në veçanti për gradat madhore: Major, N/kolonel, Kolonel dhe Gjeneral.

4. ZBULIMI

Zbulimi si një nga elementet kyç në tërësinë e detyrave në kuadër të misionit të FA përben edhe një nga prioritetet e punës së Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të FA. Gjatë vitit 2012 zbulimi duhet të zhvillojë në mënyrë bashkëkohore kapacitetet informative duke aplikuar standardet e NATO-s në tërë aspektet e veprimtarisë së tij si shërbim që nga planifikimi, grumbullimi, menaxhimi analizimi dhe transmetimi i sigurt i informacionit.

Synim themelor duhet të jetë rritja e cilësisë analitike e parashikuese të produktit të zbulimit. Ky objektivi do të arrihet duke zhvilluar struktura mbi konceptin e ri të integruar të burimeve dhe në një kulturë të re të përdorimit të përbashkët të informacionit.

Objektiv konkret të jetë rritja e kapaciteteve operacionale në nivel taktik. Gjithashtu prioritet t'i jepet sigurisë së informacionit dhe tërësisë së masave që do të merren në këtë drejtim për të plotësuar standardet e NATO-s për menaxhimin e informacionit. Të vihen në efektivitet të plote sistemet e integruar të sigurisë elektronike duke synuar mbështetje të afërt direkte në zbulim dhe siguri të objekteve e aktiviteteve të FA.

5. PËRGATITJA PËR MISIONIN KUSHTETUES DHE ZHVILLIMI I KAPACITETEVE OPERACIONALE

Rishikimi i paketës së kontributeve në operacionet e mbështetjes së paqes të realizohet në përputhje me politikat e Aleancës për tranzicionin në Afganistan, me qëllim transferimin gradual të përgjegjësisë në fushën e sigurisë tek autoritet vendase. Ky rishikim të synojë rritjen e cilësisë së përfaqësimit me personel trajnues si dhe pjesëmarrjen me oficerë shtabi në Komandat Operacionale të NATO-s, në varësinë e të cilave vendi ynë ka dislokuar trupa. SHPFA të marrë të gjitha masat për të planifikuar, përgatitur, organizuar dhe mbështetur me cilësi angazhimet e ushtarakëve tanë përfaqësues në shtabet e OMLT, NTM-A, POMLT, KFOR dhe EUFOR, si dhe në operacionet e drejtuara nga BE dhe OKB.

Të studiohet e zbatohet koncepti i përdorimit dhe sigurimit të forcave (*force user and force provider*) si dhe koncepti i Elementëve të Mbështetjes Kombëtare (NSE). Të vijojë kontributi me ekipin e OMLT, duke ulur si numër pjesëmarrjen me forca të mbështetjes së luftimit. Të përgatitet dhe dërgohet për herë të parë në Afganistan, një togë mjekësore, në kuadër të misionit të NATO-s , ISAF.

Krahas angazhimeve për pjesëmarrjen në operacione në mbështetje të paqes, rëndësi e veçantë t'i kushtohet planifikimit, përgatitjes dhe zhvillimit të operacioneve në përgjigje të emergjencave civile, duke përgatitur njëkohësisht dokumentet doktrinarë përkatëse.

a. Koncepti i planëzimit dhe zhvillimit të stërvitjes në FA

Stërvitja mbetet faktori kryesor për shndërrimin e një formacioni ushtarak në një forcë të aftë dhe operacionale. Në këtë kontekst edhe gjatë vitit 2012 stërvitja do të jetë qendra e gravitetit e veprimtarisë së FA-së. Të zbatohet një sistem objektiv i matjes së rezultateve dhe progresit në stërvitjen e njësisë, reparteve e nënreparteve. Ky sistem të jetë i thjeshtë, i kuptueshëm dhe i zbatueshëm sipas standardeve të NATO-s.

- Të gjitha nivelet e drejtimit në FA të vijojnë standardizimin dhe konsolidimin e sistemit të stërvitjes individuale dhe asaj kolektive, në funksion të përmbushjes së misioneve dhe detyrave të sotme dhe të ardhshme të FA-së në planin kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Një vend të veçantë në planet stërvitore t'i kushtohet trajnimit për rritjen e ndërveprueshmërisë së reparteve dhe njërive në stërvitje të përbashkëta dy apo shumëpalëshe, me fokus te njësitë e deklaruara në "NATO Pool of Forces".
- Prioritet t'i jepet konsolidimit të stërvitjes kolektive në nivel kompanie dhe përsosjes së metodave të planëzimit dhe zhvillimit të saj për kompaktësimin deri në nivel batalioni.
- Planifikimi i stërvitjes të përfshijë detajimin e detyrave për të gjitha strukturat me synim përgatitjen për vlerësimin, certifikimin dhe afirmimin e njërive dhe reparteve deklaruara në "NATO Pool of Forces".

b. Prioritetet e stërvitjes gjatë vitit 2012

1. Stërvitje për rritjen e kapaciteteve operacionale në funksion të gatishmërisë luftarake të formacioneve.
2. Stërvitje para-dislokim e nënreparteve që përgatiten për dislokim në teatrin e operacioneve në Afganistan duke u bazuar në kërkesat e STANAG 6023 "Edukimi dhe Stërvitja për Operacionet e Mbështetjes së Paqes".
3. Stërvitje për emergjencat civile, për përballimin e fatkeqësive të ndryshme natyrore dhe atyre të shkaktuara nga dora e njeriut.
4. Stërvitje për konsolidimin e përdorimit të forcave sipas konceptit "Joint," që për kushtet e Forcave tona të Armatosura do të konsiderohet stërvitja e "Task-Force".

6. MENAXHIMI I MBROJTJES

a. Burimet Njerëzore. Objektivi kryesor të jetë plotësimi i strukturave të Mbrojtjes me personel plotësisht profesionist, të aftë për plotësimin e misionit. Gjatë vitit 2012 të mbahen parasysh çështjet si: rritja e cilësisë së arsimimit të oficerit, të nënoficerit, të ushtarit profesionist, dhe në veçanti të trajnimit të personelit civil në nivel të krahasueshëm me vendet e NATO-s, për të realizuar objektivin për një FA plotësisht profesioniste.

b. Burimet Materiale. Krijimi dhe konsolidimi i Sistemit të Kodifikimit dhe Informatizimit Logjistik të shërbejë për unifikimin e procedurave dhe të kodeve të menaxhimit të materialeve, sipas sistemit të NATO-s.

c. Programimi i burimeve të mbrojtjes. Programet e Mbrojtjes 2012-2017 të synojnë programimin e zhvillimit afatmesëm të FA-së, modernizimin dhe transformimin e tyre në një forcë me kapacitete operacionale të aftë për të realizuar misionet kushtetuese, për të plotësuar detyrimet si vend anëtar i NATO-s dhe detyrimet ndaj strukturave të tjera ndërkombëtare të sigurisë. Ato të sigurojnë implementimin e OF-ve në afatet e parashikuara në dokumentet përkatëse.

Gjatë vitit 2012 të realizohet sinkronizimi i mëtejshëm i fazës së programimit me Sistemin e Integruar Kombëtar dhe sistemin e PPBE të NATO-s.

Programimi i burimeve të mbrojtjes të referohet konceptit "smart defense" të Aleancës. Në këtë kuadër FA kanë deklaruar angazhime konkrete në tetë projekte, në

kuadrin Projekteve ACT-se për krijimin e Kapaciteteve Shumëkombëshe e Zgjidhjeve të Reja për këtë qëllim.

Për secilin program të vlerësohen shpenzimet dhe të evidentohen mundësitë reale të burimeve të mbrojtjes duke mbajtur parasysh alokimet buxhetore krahas kërkesave operacionale. Kërkesat për ndërtime, projekte dhe rikonstruksione të planifikohen fillimisht për strukturat dhe garnizonet prioritare për të mbështetur zhvillimin dhe modernizimin e FA-së.

Planifikimi buxhetor të kryhet në përputhje me prioritetet kryesore të FA si dhe programeve të mbrojtjes duke analizuar veçanërisht raportet e projekteve të modernizimit me ato të infrastrukturës me synim rritjen e efikasitetit të tyre. Kjo do të kërkojë një qasje financiare, e cila të ketë si qëllim kryesor racionalizimin e shpenzimeve buxhetore, rritjen e efektivitetit dhe qëndrueshmërisë së sistemit buxhetor të Ministrisë së Mbrojtjes.

Programi i modernizimit të teknikës dhe pajisjeve ushtarake të bëhet në vijimësi në përputhje me prioritetet dhe projektet e parashikuara në Programet e Mbrojtjes 2011-2016. Investimet në infrastrukturë dhe modernizim të mbështesin kryerjen e misioneve aktuale dhe atyre të parashikuara për FA-në për të ardhmen.

d. Zbatimi i Buxhetit. Viti 2012 të jetë vit i shpenzimeve të përqendruara, me disiplinë të rreptë financiare dhe bazuar në prioritetet. Për këtë:

- Të merren të gjitha masat për përqendrimin e fondeve në ato drejtime të cilat rritin kapacitetet operacionale;
- Planet dhe programet vjetore të punës të strukturave të MM dhe FA të ripunohen, përshtaten dhe zbatohen në përputhje me fondet e alokuara;
- Të përmirësohet sistemi i përgatitjes së buxhetit, duke e bërë atë gjithëpërfshirës, të thjeshtë dhe transparent;
- Të përmirësohet dhe të rritet cilësia e raportimit për realizimin e buxhetit dhe të programeve të mbrojtjes;
- Të konsolidohet më tej sistemi i PPBE dhe integrimi i tij me SPI;
- Prokurimet të synojnë përqendrimin e blerjes së mallrave dhe shërbimeve që janë të përbashkëta për të gjithë strukturat e FA;
- Auditit të forcojë kontrollin mbi shpenzimet, duke kërkuar edhe efektivitetin e arritur për çdo fond të shpenzuar.

7. ARSIMIMI USHTARAK DHE STËRVITJA

Prioritetet kryesore të FA-së për stërvitjen në vitin 2012 të jenë planëzimi, menaxhimi, përmirësimi, zhvillimi dhe ndjekja e procesit të stërvitjes në përputhje me legjislacionin, zhvillimet bashkëkohore dhe standardet e NATO-s.

Detyrë parësore për të gjitha nivelet e komandimit në FA të jetë konsolidimi i sistemit arsimor dhe stërvitjes që përben elementet baze të përmbushjes së misionit të detyrave të sotme e të ardhmes së FA-së në planin kombëtar dhe ndërkombëtar.

Detyrë parësore të jetë gjithashtu përgatitja e oficerëve të rinj. Sistemi i ri i përgatitjes së oficerëve të rinj të behet mbi baza të shëndosha me programe të reja me qëllim rritjen e qëndrueshmërisë në procesin e përgatitjes së oficerëve në Akademinë Ushtarake. Programi për vitin 2012 të pasqyrojë format dhe metodat për zhvillimin e arsimimit, trajnimit, stërvitjes dhe vlerësimit të gjitha strukturave dhe kategorive të personelit të FA-së.

Në mënyrë të veçantë të vlerësohen përgatitja me cilësi e udhëzimeve vjetore të stërvitjes ku të përfshihen trajnimi i komandave e shtabeve, trajnimi individual e kolektiv, stërvitjet kombëtare e ndërkombëtare si dhe trajnimi funksional i operacioneve. Të përfshihen gjithashtu marrëdhëniet civilo-ushtarake, të mbrojtjes nga ADM, lufta kundër terrorizmit, veprimtaritë antitrafik, operacionet humanitare e ato në ndihmë të popullsisë brenda vendit.

Një vend i veçantë në këtë plan vjetor ti kushtohet trajnimit për Objektivat e Forcës, përgatitjes së forcave për operacionet jashtë vendit, zhvillimit të stërvitjeve të përbashkëta “Joint”, përgatitjes së skenarëve e planeve metodike në nivel batalioni, deri në nivel komandë force, zhvillimin e stërvitjeve me NATO-n si dhe ato në kuadër dypalësh, të cilat të planifikohen e realizohen në mbështetje të OF-ve.

Për nënrepartet e deklaruara në NATO “Pool of Forces” të realizohen vlerësime kombëtare gjatë vitit 2012, me qëllim kryerjen e certifikimit kombëtar po brenda këtij viti, afirmimin e tyre nga NATO për periudhën afatmesme.

Mbështetur në Politikën e Arsimit për Programin e Gjuhës Huaj, trajnimi i personelit të FA-së në gjuhën angleze, të bëhet sipas STANAG-ut 6001 si dhe të fillojë trajnimi i personelit në gjuhën e vendeve ku forcat tona marrin pjesë në operacion.

8. MODERNIZIMI DHE PUNA KËRKIMORE

Gjatë vitit 2012 puna kërkimore të mbështesë projektet madhore të modernizimit, të konsolidojë investimet e bëra dhe të rrisë efektivitetin e përdorimit të tyre në kuadër të veprimtarive të FA. Përparësi ti jepet mbështetjes së projektit të ndërtimit të anijeve patrulluese në Forcën Detare; mirëmbajtjes së flotës ekzistuese, aftësimi profesional të pilotëve si dhe rritjes së kapaciteteve të Forcave Ajrore nëpërmjet blerjes së helikopterëve të rinj; vijimit të mbështetjes së Forcave Tokësore me sisteme, pajisje dhe armatim të nivelit taktik duke synuar rritjen e operacionalitetit të trupave në misione si dhe implementimin e projektit të uniformës së re të Forcave të Armatosura.

Projektet e reja të modernizimit të orientohen drejt zgjidhjeve të integruara dhe të plota, të shtrira në disa vite buxhetore dhe drejt krijimit të raporteve të balancuara në modernizimin e armëve dhe shërbimeve. Ato të konsiderohen pjesë integrale të një sistemi të plotë që zhvillohet në mënyrë të shkallëzuar dhe në sinkron me planet e ardhme të zhvillimit dhe modernizimit të Forcave të Armatosura. Investimet e reja të udhëhiqen nga analiza dhe menaxhimi i ciklit jetësor të tyre si dhe të jenë në harmoni e në kuadër me planet e zhvillimit të forcave të NATO-s.

Investimet që janë bërë në Forcat e Armatosura në teknike, pajisje, sisteme dhe armatime, kanë rritur aftësisë operacionale dhe vit pas viti ato janë një kapacitet i shtuar në kompletimin e Forcave të Armatosura. Komandat e niveleve të ndryshme duhet të maksimizojnë efektivitetin e këtij investimi duke synuar aftësimin e personelit në njohjen e përdorimit të teknikes dhe sistemeve, krijimin e një koncepti të ri mirëmbajtje dhe shndërrimin e këtij investimi në tregues të matshëm të aftësisë operacionale.

Planifikimi i aktiviteteve vjetore për institucionet arsimore, shkencore dhe komandat të rrisë punën studimore me tendencë zhvillimit të FA-së në përshtatje me Konceptin e Ri Strategjik të NATO-s.

Puna studimore të synojë:

- Zhvillimin e zbatimit të doktrineve të NATO-s;
- Transformimin e FA-së në një forcë plotësisht profesioniste;

- Rritjen e kapaciteteve operacionale;
- Rritjen e peshës së kontributeve në misionet në kuadër të NATO-s;
- Modernizimin dhe pajisjen e FA-së sipas standardeve të NATO-s.

Krijimi i Institutit të Studimeve Strategjike të Sigurisë dhe Mbrojtjes

Koncepti i Ri Strategjik i NATO, Procesi i Planifikimit të Mbrojtjes i NATO, Koncepti i Mbrojtjes Kolektive apo ai i “Smart Defence,” bëjnë të domosdoshme, tashmë edhe për Shqipërinë, krijimin e një sistemi të harmonizuar, të integruar e unik të sigurisë dhe mbrojtjes në nivel kombëtar.

Ky Institut duhet të fillojë të funksionojë si një qendër e përbërë nga ekspertë të sigurisë e mbrojtjes, inteligjencës, të planifikimit e menaxhimit të burimeve të mbrojtjes, studiuës të gjeopolitikës e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomatë të karrierës.

Duke analizuar dhe harmonizuar politikat dhe qëndrimet kombëtare ndaj mjedisit të sigurisë, mbrojtjes kolektive, emergjencave civile, sigurisë publike dhe rendit kushtetues, planifikimit dhe modernizimit të mbrojtjes sipas kapaciteteve kritike të Paketës së Lisbonës, dokumentet strategjike të NATO-s dhe Shqipërisë, politikat e zhvillimit teknologjik dhe të informacionit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, Instituti të ketë si mision:

1. Analizimin dhe studimin e mjedisit të sigurisë brenda hapësirës territoriale të Kombit Shqiptar.
2. Përcaktimin e nivelit riskut ndaj sigurisë kombëtare krahasimisht me situatën rajonale apo më gjerë.
3. Analizimi i kapaciteteve të mbrojtjes dhe efektivitetin e tyre.
4. Garantimin e harmonizimit legjislativ dhe veprimtarisë institucionale në fushën e sigurisë.

Duke vepruar si një “Think Tank”, Instituti do të ofrojë ekspertizën e nevojshme për Ministrinë e Mbrojtjes, duke kryer studimet dhe ofruar metodologjinë e duhur për orientimet strategjike brenda dhe jashtë vendit, për hartimin dhe përpunimin e Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes, Strategjisë Ushtarake, projektet ndërkombëtare të modernizimit në kuadër të “Smart Defence”, planifikimin dhe menaxhimin me sukses të buxhetit të mbrojtjes, veçanërisht në termat e menaxhimit të integruar afat-mesëm e afatgjatë.

Ajo gjithashtu do të përbëjë nuklin analizues, studimor dhe rekomandues për politikat gjeo-strategjike rajonale në shërbim të Ministrisë Jashtme në çështje të sigurisë, promovimin e lobingut në mbrojtje të interesave kombëtare, intensifikimin e marrëdhënieve politiko-diplomatike me institucionet dhe organizatat ndërkombëtare në fushën e sigurisë.

9. MBËSHTETJA LOGJISTIKE

Objektivi i strukturave logjistike të jetë ngritja dhe funksionimi i logjistikës së integruar, rishikimi i kapaciteteve për mbështetje të operacioneve, brenda dhe jashtë vendit sipas standardeve të NATO-s. Planëzimi, standardizimi dhe informatizimi logjistik të synojë sigurimin, koordinimin dhe kontrollin e aktiviteteve logjistike.

Procedurat e prokurimit për fondet e akorduara për blerje mallra, shërbime dhe investime për vitin 2012 të bëhen të përqendruara në MM, Ministrinë e Brendshme, në Brigadën Logjistike, dhe të decentralizuara në Komandat e Forcave, në bazë të urdhrave, udhëzimeve dhe autorizimeve të MM-së, SHSHFA-së.

a. Uniformat e Reja. Implementimi: Një nga përparësitë e këtij viti të jetë implementimi i projektit të uniformës së re të Forcave të Armatosura, i cili të shtrihet në disa vite. Mbështetur në vendimet përkatëse të qeverisë, platforma e kalimit në uniformën e re të realizohet në dy faza kryesore.

Gjatë fazës së parë të synohet kompletimi pjesor i strukturave të Forcave të Armatosura me uniformën e ceremonialit/punës/veshjeve speciale, dekoracioneve, simboleve, shenjave që vendosen në uniformë dhe të stemave dhe flamujve dekorativë të Forcave dhe njësisive kryesore. Kjo fazë të finalizojë kalimin në uniformën e re të FA me rastin e 100 vjetorit të krijimit të Shteti Shqiptar. Faza e dytë, e cila do të ketë shtrirje disa vjeçare, të synojë implementimin e plotë të projektit të uniformës së ceremonialit, punës, veshjeve speciale dhe të stërvtijes.

b. Automatizimi: Brenda 3 mujorit të parë të vitit 2012 të përgatitet koncepti i integruar për automatizimin në FA, i shoqëruar me koston përkatëse. Brenda vitit 2012 të ndërtohen dhe vihen në funksionim moduli i financës, personelit dhe materialeve logjistike. Përgatitja e konceptit të shoqërohet me studimin e mundësisë së kapaciteteve transmetuese të Sistemit të Ndërlidhjes dhe Informacionit për mbështetjen dhe ndërtimin e moduleve të automatizimit, si dhe me hartimin dhe zbatimin e projekteve për përmirësimin në të ardhmen të kapaciteteve transmetuese në përputhje me fazat e automatizimit. Për vënien dhe mbajtjen në funksionim të moduleve të automatizimit paraprakisht të bëhet përzgjedhja dhe përgatitja profesionale e personelit përkatës.

c. Infrastruktura: Bordi i Modernizimit të Infrastrukturës në bashkëpunim me strukturat e MM dhe FA të përgatisë dokumentin e kërkesave për ndërtimin dhe përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese. Të përmirësohet puna e strukturave të specializuara në MM dhe FA, dhe brenda vitit 2012 të rishikohen dhe përgatiten masterplanet për të gjithë garnizonet kryesore në përputhje me planin e përhapjes. Ndërtimet në infrastrukturë të synojnë përqendrimin e strukturave të MM dhe FA në sa më pak garnizone dhe ndërtimin e objekteve me strukturë të përkohshme. Ndërtimet e reja, ristrukturimi i objekteve të vjetra, sistemimi i ambienteve të jashtme të garnizoneve dhe institucioneve ushtarake të bëhet bazuar në projekte të miratuara dhe në përputhje me kërkesat ligjore për mbrojtjen e mjedisit.

c. Transporti: Shtabi i Përgjithshëm i FA të ripunojë konceptin e mbështetjes me transport të strukturave të FA, bazuar në skenarët e mundshëm, konceptin e vendeve të NATO-s, gjendjen e mjeteve që kemi në përdorim, mundësitë reale të buxhetit për të përballuar blerje të reja dhe të dhënat historike. Përpunimi i konceptit duhet të përfshijë mjetet tokësore, detare, ajrore si dhe përdorimin e integruar të tyre. Kërkesat për transport të shoqërohen me rishikimin e TOP, si për sasinë e mjeteve, të personelit drejtues, të personelit për riparim-mirëmbajtje ashtu edhe të fondeve që harxhojmë. Të rishikohet sasia e mjeteve që kemi në përdorim dhe të propozohen për nxjerrje jashtë përdorimit ato mjete që nuk janë eficientë dhe që nuk i duhen FA. Sasia e mjeteve që i duhen FA të përcaktohet bazuar në alternativat më të mira dhe efektive për realizimin e detyrave të përditshme, detyrave në rast operacionesh, emergjencash dhe kohë të veçantë. Bazuar në mundësitë financiare të buxhetit dhe prioritetit të zëvendësimit të mjeteve që do të dalin jashtë përdorimit të detajohet blerja e mjeteve të reja.

Për këtë:

- Mjetet të grupohen në struktura të veçanta, të specializuara për transportin. Në strukturat e FA të qëndrojnë vetëm ato mjete që janë tepër të domosdoshme për aktivitetin e përditshëm.
- Të studiohen dhe të përcaktohen fushat e transportit për të cilat FA do të mbështeten tek të tretët, duke përmirësuar cilësinë dhe ulur koston.
- Prioritet të ketë përmirësimi i transportit të përditshëm të personelit dhe delegacioneve të huaja që vizitojnë vendin tonë.

d. Mbrojtja e mjedisit: Ngritja e Bordit të Mjedisit dhe përgatitja e Dokumentit të Politikave Mjedisore duhet të synojnë zhvillimin e projekteve të cilat vendosin MM dhe FA në raportet e duhura ndaj mjedisit dhe mbrojtjes së tij, e parë kjo jo vetëm në operacionet brenda vendit por edhe në misionet jashtë vendit. Rëndësi e veçantë t'i kushtohet përgatitjes dhe miratimit të STANAG-ve përkatës në fushën e mjedisit. Nëpërmjet formave të larmishme, stërvitjes dhe arsimimit të rritet ndërgjegjësimi i të gjithë personelit të MM dhe FA për mbrojtjen e mjedisit. Projektimi dhe ndërtimi i objekteve të reja të bëhet në përputhje me standardet e miratuara mjedisore. Brenda vitit 2012, ISPMb në bashkëpunim me LQ të FA të përfundojnë vlerësimin e plotë të ndikimit mbi mjedisin të poligoneve të qitjes, uzinave ushtarake dhe poligoneve të demontimit. Të përfundojnë projektet dhe udhëzimet përkatëse për menaxhimin e mbetjeve urbane dhe mbetjeve të SUQU. LQ i FA të monitorojë në vazhdimësi gjendjen e ajrit, ujit dhe tokës, të përcaktojë nivelin e ndotjes dhe të propozojë detyrat përkatëse për strukturat e MM. Të gjitha strukturat e MM të dorëzojnë ndotësit e mundshëm që kanë mundësi shitje, si bateritë e makinave, vajrat, gomat e dala jashtë përdorimit në strukturën që do të përcaktohet nga Shtabi i Përgjithshëm i FA.

Projektet e mësipërme do të reduktojnë në maksimum rreziqet për jetën e njerëzve dhe për mjedisin, duke bërë më të mirë jetesën në strukturat e MM. Brenda vitit 2012 SUQU, Shtëpitë e Pushimit, Uzinat Ushtarake, poligonet e asgjësimit të municioneve të kenë nivelin e ndikimit në mjedis brenda normave të lejuara nga legjislacioni kombëtar; të gjithë strukturat e MM të menaxhojnë dhe grumbullojnë mbeturinat në përputhje me legjislacionin në fuqi; dhe të përmirësohet në nivel të dukshëm gjelbërimi në të gjithë garnizonet dhe strukturat e MM.

10. BASHKËPUNIMI USHTARAK

Gjatë vitit 2012 të vazhdojë puna për konsolidimin e bashkëpunimit me strukturat e NATO-s, duke pasur si synim integrimin në strukturat e komandimit të Aleancës. Në këtë kuadër të vijojë puna për plotësimin e pozicioneve të alokuara në komandat e NATO-s për të arritur plotësimin e tyre deri në 65%, nga 30% që është aktualisht. Rëndësi e veçantë t'i kushtohet programimit, përgatitjes dhe certifikimit të forcave të deklaruara në NRF me synim vendosjen e tyre dispozicion të NATO-s. Rëndësi t'i kushtohet zbatimit të Planit të Integritimit me Komandën e NATO-s për Transformimin (ACT) dhe Planit të Punës për Integrim me Komandën e Forcës së Bashkuar të Napolit (JFC-N)

11. BASHKËPUNIMI ME JASHTË

Eksperienca e deritanishme, sidomos pas anëtarësimit të vendit tonë në NATO, ka diktuar standarde dhe praktika të reja të punës e veprimtarisë në kuadër të mbrojtjes, duke përfshirë edhe bashkëpunimin ushtarak me jashtë. Në këtë kontekst, duke synuar

zgjërimit e hartës së bashkëpunimit, bashkëpunimi bilateral duhet të kthehet përfundimisht në një partneritet mbi bazën e parimit të “cost-sharing,” të jetë komplementar dhe në shërbim të rritjes dhe konsolidimit të kapaciteteve tona, për zhvillimin e transformimin e FA, realizimin e Objektivave të Forcës (FG), pjesëmarrjen në operacione të drejtuara nga NATO, BE apo OKB, si dhe në përbalimin e emergjencave civile. Bashkëpunimi me vendet anëtare të NATO-s ose atyre partnere të konceptohet në funksion të kontribuimit në krijimin e një ambienti paqeje e stabiliteti në rajon dhe në botë, ri-modelimit të mënyrës së vepruarit dhe menduarit rreth çështjeve të forcimit të sigurisë, si dhe zgjerimit të kapaciteteve mbrojtëse të vendit.

Gjendjes aktuale por edhe të perspektivës të mjedisit të sigurisë, Shqipëria do t’i përgjigjet nëpërmjet politikave realiste të sigurisë e mbrojtjes, marrëdhënieve me jashtë, zgjedhjes së aleatëve strategjikë dhe gjetjes së rrugëve më të përshtatshme për arritjen e synimeve e objektivave në fushën e mbrojtjes, duke u bërë një faktor paqeje e stabiliteti për rajon e më gjerë. Bashkëpunimi i Shqipërisë me vendet aleate dhe rajonale do te vijoje qofte në kuadrin e iniciativave rajonale, ku Shqipëria do të luaje një rol me aktiv si një vend anëtar i NATO-s, por edhe ne kuadrin e angazhimeve dhe detyrimeve qe rrjedhin nga kjo anëtarësi.

Vëmendje e veçantë do t’i kushtohet zhvillimit të diplomacisë së mbrojtjes, si një mjet në ndihmë të politikës së jashtme të vendit, duke ndërmarrë hapa e veprimtari për ta materializuar atë nëpërmjet bashkëpunimit ushtarak me jashtë. Rendësi do t’i jepet takimeve në nivel të lartë, ne nivel Ministrash apo te Shefave te Shtabit jo vetëm të vendeve me të cilat kemi aktualisht një bashkëpunim shumëvjeçar të konsoliduar por edhe ngritjen e marrëdhënieve bilaterale në fushën e ushtarake me vende me të cilat nuk kemi pasur të tilla marrëdhënie deri tani

Përparesi do t’i jepet bashkëpunimit në kuadër të SEEDM-it dhe A-5, si iniciativa shumë frutdhënëse. Në kuadër, Shqipëria do të vazhdojë të jetë aktive dhe të japë kontributin e saj në funksion të ri-dimensionimit të bashkëpunimit rajonal në përputhje me konceptet “smart defense” si dhe “pooling and sharing” të burimeve të mbrojtjes, duke synuar gjetjen e fushave konkrete të cilat bëjnë të mundur realizimin e koncepteve të mësipërme, si dhe shmangien e mbivendosjeve apo dublimeve të panevojshme.

12.ASGJËSIMI I MUNICIONEVE TE TEPËRTA

Asgjësimi i municioneve tepërta do të vijoje të jetë një ndër prioritet kryesore të punës së Qeverisë Shqiptare dhe në këtë kuadër kërkohet angazhim maksimal i FASH. Viti 2012 është vendimtar për asgjësimin e gjithë sasisë së municioneve në përmbushje të synimit të Qeverisë të që kjo detyrë të përfundojë brenda vitit 2013.

Gjatë vitit 2011, pas nënshkrimit të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të RSH dhe NAMSA, është implementuar projekti i NAMSA-s në ULP Mjekës, janë shtuar edhe 3-linja të reja të demontimit industrial të municioneve, janë reduktuar 5-grup depo municioni dhe u realizua objektivi për asgjësimin e afërsisht 27,000 ton municioneve. Në vitin 2012, si vit përcaktues për procesin, të planifikohen fondet e nevojshme të buxhetit shtetit për asgjësimin e municioneve, përdoren me efektivitet fondet e vëna në dispozicion të projektit të NAMSA-s nga Qeveria Amerikane si dhe të punohet për sigurimin e donacioneve nga vende të tjera. Përfaqësia e RSH dhe

Përfaqësia Ushtarake në NATO si dhe Atashetë Ushtarakë të RSH në vende të ndryshme, të bëjnë të gjitha përpjekjet për sigurimin e fondeve ose pajisjeve në mbështetje të demilitarizimit të municioneve të tepërta.

Gjatë vitit 2012, të planifikohen për asgjësim rreth 25,000 ton municione, duke zbatuar standardet e sigurisë, shtuar kapacitetet e demontimit, rritur efektivitetin e linjave të demontimit industrial. Prioritet në asgjësimin e municioneve të jetë demontimi industrial. Të planifikohet dhe realizohet përfundimi i procesit të asgjësimit me detonim në poligone dhe të shmangim aksidentet.

Ndërkohë që 2011 ishte viti i planifikimit të materialeve të tepërta dhe evadimit të tyre, viti 2012 duhet të shënojë përfundimin e procesit të evadimit dhe përqendrimit të materialeve dhe pronave të tepërta. Për këto të fundit, ky proces do të karakterizohet nga një intensifikim i procedurave lidhur me privatizimin e pronave të tepërta në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes. Kjo të bëhet e mundur përmes procedurave të shpejta dhe fleksible të dërgimit të pronave në Ministrinë e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës, si dhe ndjekja e procedurave ligjore të vlerësimit të pronës deri në zhvillimin e ankandit për shitjen e pronave, duke bashkëpunuar me ministritë e linjës për këtë qëllim.

13.VITI 2012, VIT I 100 VJETORIT TË PAVARËSISË DHE KRIJIMIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA

Viti 2012 për FA të konsiderohet si vit i veçantë, pasi ka të bëjë me ngjarjet më të rëndësishme të kombit tonë, atë të 100 vjetorit të Pavarësisë dhe krijimit të FA Shqiptare. Për këtë, të gjitha strukturat e FA të planëzojnë dhe realizojnë një sërë aktivitete, duke filluar nga hallka më e vogël e deri në ato në shkallë Force të Armatosur, të lidhura e të harmonizuara me aktivitetet e tjera të Qeverisë në shkallë vendi. Aktivitetet t'u bëjnë jehonë momenteve më kulmore që çuan në shpalljen e pavarësisë e krijimin e shtetit shqiptar, rrugën 100 vjeçare të konsolidimit të tij, si dhe përpjekjeve për krijimin, zhvillimin dhe modernizimin e vazhdueshëm të Forcave të Armatosura ndër vite, e deri në ditët e sotme, si pjesë e Aleancës më të madhe të mbrojtjes së lirisë e pavarësisë së popujve, në atë të NATO-s.

Për këtë qëllim stafi i integruar i MM/SHPFA dhe Komandat e Forcave e njësisë të planëzojnë dhe realizojnë veprimtari të ndryshme, ku ndër më kryesoret të jenë:

- Organizimi dhe zhvillimi i Paradës Ushtarake, në të cilën të ftohen për të marrë pjesë edhe përfaqësues të Veteranëve, Forcave të Sigurisë së Kosovës, si dhe flamurtarë të vendeve të NATO-s dhe vendeve të Rajonit.
- Përgatitja dhe mbajtja e referateve të ndryshme në njësi e reparte, që i bëjnë jehonë rrugës së krijimit dhe konsolidimit të shtetit shqiptar dhe të Forcave të Armatosura, të cilat të kurorëzohen me mbajtjen e një Konference Shkencore me temë: “100 vjet Forcë e Armatosur Shqiptare”.
- Organizimi dhe zhvillimi i koncerteve të Orkestrës Frymore të Forcave të Armatosura me pjesë patriotike, realizuar në mjedise të ndryshme publike të vendit dhe kurorëzimi i tyre me një koncert të madh përmbyllës të gjitha veprimtarive të nëntorit në Tiranë me pjesë e këngë patriotike.
- Organizimi i ekspozitave të ndryshme, realizimi i emisioneve televizive, si dhe përgatitja e një filmi dokumentar, të cilat t'u bëjnë jehonë përpjekjeve, arritjeve në

rrugën e modernizimit të Forcave të Armatosura nga dita e krijimit e deri në ditët e sotme.

- Ri-evidentimi i dëshmorëve të Atdheut dhe botimi i një libri kushtuar jetës dhe aktivitetit të tyre etj.

14.MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

Viti 2012, si viti i 100 vjetorit të krijimit të Forcave të Armatosura duhet të jetë një vit model angazhimi me publikun, duke rritur kështu edhe më tej besimin e ndërsjellë ndërmjet publikut dhe FA. Për këtë të hartohet një program ambicioz i marrëdhënieve me publikun, realizimi me sukses i të cilit do të kërkojë angazhimin e të gjitha strukturave të FA dhe Ministrisë së Mbrojtjes. Ky vit duhet të jetë viti i dinamizimit të komunikimit të FA me publikun nëpërmjet medimeve klasike, prodhimit të reportazheve dhe dokumentarëve televiziv, “talk show-ve” që pasqyrojnë krijimin dhe transformimin e Forcave tona të Armatosura në një forcë profesionale dhe moderne. Po ashtu, faja zyrtare e MM duhet të shndërrohet në një portal të lajmit të mbrojtjes, të përcjellim të gjithë ekspertizën dhe informacionin që kemi për çështje të sigurisë së vendit.

QKMBM tashmë ka ndërtuar profilin e saj si një institucion që prodhon aktivitete artistike, të cilët kanë kontribuar cilësisht në jetën kulturore të vendit. Plani i aktiviteteve për vitin 2012 duhet të jetë edhe më ambicioz, në mënyrë që të jepet një kontribut substancial për kremtimin e 100 vjetorit të krijimit të Shtetit Shqiptar dhe Forcave të tij të Armatosura. Ky vit duhet të jetë viti i vendosjes së OFFA në qendër të elitës muzikore të vendit, i diversifikimit të aktiviteteve të saj, i rikthimit në qendër të vëmendjes të muzikës dhe instrumenteve të traditës së hershme shqiptare.

Pjesëtarë të Forcave të Armatosura,

Reforma e Mbrojtjes e FASH ka krijuar vizionin e plotë dhe në mbështetje të saj tashmë janë siguruar në një masë të kënaqshme burimet, njerëzore, materiale e financiare. Në të ardhmen përpara nesh do paraqiten sfida të reja ndër të cilat më kryesorja do vijojë të mbetet lufta e përhershme për arritjen dhe ruajtjen e standardeve të nevojshme të një vendi anëtar të NATO-s. Përballë këtyre sfidave, përkrah përpjekjeve tona, konstatohet mbështetja e plotë e qeverisë shqiptare e shoqërisë në tërësi, si dhe një mbështetje reale e shumë efektive nga NATO si një e tërë por edhe nga vendet anëtare në veçanti.

Direktiva e vitit 2012 të përbejë bazën, në të cilën do të mbështeten planet e programet e punës e të veprimtarive kryesore të gjithë strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Forcave të Armatosura.

Ecuria e zbatimit të saj të raportohet periodikisht.

MINISTRI I MBROJTJES

ARBEN IMAMI